Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian

BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës



# Konkurs Fotografie

## Ta sjellim DREJTËSINË më pranë qytetarëve!

**Dita Evropiane e Drejtësisë** festohet çdo vit rreth datës 25 Tetor. Ajo synon të sjellë drejtësinë më afër qytetarëve, t'i informojë ata për të drejtat e tyre dhe të promovojë punën e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në fushën e qasjes në drejtësi.

Që nga viti 2020, Dita Evropiane e Drejtësisë shënohet në Maqedoninë e Veriut me takime publike dhe aktivitete të tjera që organizohen si pjesë e nismës së përbashkët ndërgjegjësuese të BE-së dhe Këshillit të Evropës për Ndihmën Juridike Falas (NJF).

Kjo iniciativë organizohet në kuadrin e projektit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë".

**Dita Evropiane e Drejtësisë** këtë vit do të shënohet me organizimin e konkursit fotografik me titull **"Ta sjellim drejtësinë më pranë qytetarëve"**.

Ftojmë të rinjtë (18-30 vjeç) nga të gjitha rajonet e Maqedonisë së Veriut të jenë pjesë e këtij konkursi që synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e qasjes në drejtësi për të gjithë pa diskriminim, në përputhje me standardet evropiane.



INFORMOHU PËR NDIHMËN JURIDIKE FALAS

EUROPEAN DAY OF JUSTICE

BE-ja me TY

Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian

BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës

# Rregullat dhe përshkrimi

**Data e aplikimit: Nga 25 Tetor deri më 25 nëntor 2023**.

**Rregullat:** Fotot origjinale dhe kreative duhet të përshkruajnë përfitimet dhe avantazhet që qasja e barabartë në drejtësi mund të sjellë në jetën e secilit. Të gjitha fotot duhet të dorëzohen me një mbishkrim shpjegues në gjuhën maqedonase.

**Moshat:** Konkursi është i hapur për fotografë amatorë të talentuar nga Maqedonia e Veriut, të moshës nga 18 deri në 30 vjeç.

**Përshkrimi:** Konkursi sfidon garuesit që të kapin thelbin e drejtësisë përmes lenteve të një aparati. Fotografët e rinj do të vlerësohen bazuar në interpretimin e tyre krijues të drejtësisë (promovimi i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës), si dhe bazuar në aspektet teknike vizuale të fotografive. Inkurajohen dhe janë të ftuar veçanërisht të marrin pjesë, fotografët që përcjellin kontekste apo mesazhe pozitive dhe fuqizuese në fotot e tyre. Fotot do të vlerësohen gjithashtu në bazë të rëndësisë së mesazhit të tyre dhe meritave të tyre artistike.

**Përzgjedhja:** Procesi i vlerësimit do të kryhet nga një ekip vlerësimi i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Evropës, përfaqësues nga skuadra e Ambasadorëve të Rinj Evropian në Maqedoninë e Veriut, si dhe profesionistë të pavarur me përvojë përkatëse.

**Ekspozita:** Të gjitha fotot e përzgjedhura do të ekspozohen për publikun në fillim të muajit dhjetor për të shënuar edhe Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut (data konkrete do të konfirmohet në vazhdim). Gjatë ekspozitës do të shpallen fituesit dhe do të ndahen Certifikatat përkatëse. Fituesit e këtij konkursi fotografie do të promovohen në kanalet e komunikimit të BE-së/Këshillit të Evropës si dhe fotot fituese do të stampohen si postera dhe do të shpërndahen në kuadrin e nismës ndërgjegjësuese për Ndihmën Juridike Falas dhe do të përdoren më tej në materialet publike të Këshillit të Evropës (raporte/fletëpalosje/studime etj).

**Si mund të aplikoni? -** Gjithçka që duhet të bëni është një foto (minimumi 6 MP në formatin .jpg), të cilën mund ta dërgoni nëpërmjet postës elektronike: DG1.FLA.NM@coe.int. Ju do të duhet të përfshini emrin, mbiemrin dhe moshën e autorit, si dhe një përshkrim/titull të shkurtër të fotografisë dhe informacionin e kontaktit. Ju lejohet të dërgoni maksimumi deri në tre (3) foto.

*Kjo iniciativë u zhvillua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.*

INFORMOHU PËR NDIHMËN JURIDIKE FALAS

EUROPEAN DAY OF JUSTICE

BE-ja me TY